J. V. STALIN

MBI MATERIALIZMIN DIALEKTIK DHE HISTORIK

TIRANË, 1968

J. V. STALIN

MBI MATERIALIZMIN DIALEKTIK DHE HISTORIK

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»
TIRANË, 1968

Materializmi dialektik është botëkuptimi i partisë marksiste-leniniste. Quhet materializëm dialektik, sepse mënyra si i trajton fenomenet e natyrës, metoda e tij për studimin e fenomeneve të natyrës, metoda e tij për njohjen e këtyre fenomeneve është *dialektike,* kurse interpretimi i fenomeneve të natyrës, të kuptuarit e fenomeneve të natyrës, teoria e tij është *materialiste.*

Materializmi historik është shtrirja e parimeve të materializmit dialektik në studimin e jetës shoqërore, është zbatimi i parimeve të materializmit dialektik në fenomenet e jetës së shoqërisë, në studimin e shoqërisë, në studimin e historisë së shoqërisë.

Duke karakterizuar metodën e tyre dialektike, Marksi dhe Engelsi i referohen zakonisht Hegelit, si filozof që ka formuluar tiparet themelore të dialektikës. Por kjo nuk do të thotë se dialektika e Marksit dhe e Engelsit është e njëjtë me dialektikën e Hegelit. Në të vërtetë Marksi dhe Engelsi morën nga dialektika e Hegelit vetëm «thelbin racional» të saj, duke e hedhur poshtë lëvozhgën idealiste të Hegelit dhe duke e zhvilluar dialektikën më tej për t'i dhënë asaj një karakter shkencor modern.

> «Metoda ime dialektike, thotë Marksi, jo vetëm që ndryshon në themel nga metoda e Hegelit, por është krejt e kundërta e saj. Për He-

gelin procesi i të menduarit, të cilin ai, duke e quajtur ide, e shndërron bile në një subjekt të pavarur, është demiurgu (krijuesi) i reales që përbën vetëm shfaqjen e jashtme të saj. Për mua, përkundrazi, elementi ideal s'është gjë tjetër veçse elementi material i bartur në kokën e njeriut dhe i transformuar në të» (*K. Marks*, «Kapitali», bot. shqip, vëll. I, 1, f. 32).

Duke karakterizuar materializmin e tyre, Marksi dhe Engelsi i referohen zakonisht Fojerbahut, si filozof që e vuri përsëri materializmin në vendin që i takonte. Mirëpo kjo nuk do të thotë se materializmi i Marksit dhe i Engelsit është i njëjtë me materializmin e Fojerbahut. Në të vërtetë Marksi dhe Engelsi morën nga materializmi i Fojerbahut «thelbin kryesor» të tij, duke e zhvilluar atë më tej në një teori filozofike-shkencore të materializmit dhe duke hedhur poshtë lëvozhgat e tij idealiste dhe etiko-fetare. Dihet se Fojerbahu, megjithëse në përgjithësi ishte materialist, qe ngritur kundër fjalës materializëm. Engelsi më se një herë ka thënë se Fojerbahu, «me gjithë bazën materialiste, akoma nuk u çlirua nga prangat e vjetra idealiste», se «idealizmi i vërtetë i Fojerbahut, bie në sy porsa arrijmë në etikën dhe në filozofinë e tij të fesë» (*K. Marks* e *F. Engels*, Vepra të zgjedhura në dy vëllime, bot. shqip, vëll. II, f. 354-356).

Dialektika vjen prej fjalës greke «dialego», që do të thotë bisedoj, polemizoj. Në kohën e vjetër me fjalën dialektikë kuptonin artin për të gjetur të vërtetën, me anën e zbulimit të kontradiktave në gjykimin e kundërshtarit dhe me anën e kapërcimit të këtyre kontradiktave. Në kohën e vjetër disa filozofë, ishin të mendjes se zbulimi i kontradiktave në të menduarit dhe ndeshja e mendimeve të kundërta është mjeti më

i mirë për të gjetur të vërtetën. Kjo mënyrë dialektike e të menduarit, e shtrirë më vonë në fenomenet e natyrës, u shndërrua në metodën dialektike të njohjes së natyrës, metodë e cila i këqyrte fenomenet e natyrës në lëvizje dhe në ndryshim të përjetshëm, kurse zhvillimin e natyrës — si rezultat të zhvillimit të kontradiktave në natyrë, si rezultat të veprimit reciprok të forcave të kundërta në natyrë.

Në themelin e saj dialektika është krejt e kundërta e metafizikës.

1) **Metoda dialektike marksiste** karakterizohet nga këto tipare themelore:

a) Në kundërshtim me metafizikën, dialektika e merr natyrën jo si një grumbull të rastit sendesh, fenomenesh të shkëputura nga njëri-tjetri, të izoluara nga njëri-tjetri dhe të pavarura nga njëri-tjetri, — por si një tërë të lidhur dhe të pandarë, ku sendet, fenomenet janë të lidhura organikisht me njëri-tjetrin, varen nga njëri-tjetri dhe kondicionojnë njëri-tjetrin.

Prandaj metoda dialektike thotë se asnjë fenomen në natyrë nuk mund të kuptohet, po të merret i izoluar, jashtë lidhjes me fenomenet që e rrethojnë, sepse çdo fenomen, në çdo fushë të natyrës, mund të bëhet diçka pa kuptim, po të merret jashtë lidhjes me kushtet që e rrethojnë, i shkëputur nga këto kushte, dhe, përkundrazi, çdo fenomen mund të kuptohet dhe të shpjegohet, po të merret në lidhjen e tij të pandarë me fenomenet që e rrethojnë, po të merret i kondicionuar nga fenomenet që e rrethojnë.

b) Në kundërshtim me metafizikën, dialektika e merr natyrën jo si një gjendje qetësie dhe palëvizshmërie, amullie dhe pandryshueshmërie, por si një gjendje lëvizjeje dhe ndryshimi të parreshtur, përtërimje-

je dhe zhvillimi të parreshtur, ku gjithnjë diçka lind dhe zhvillohet, diçka prishet dhe zhduket.

Prandaj metoda dialektike kërkon që fenomenet të shikohen jo vetëm nga pikëpamja e lidhjes dhe e kondicionimit të tyre reciprok, por edhe nga pikëpamja e lëvizjes, e ndryshimit, e zhvillimit të tyre, nga pikëpamja e lindjes dhe e zhdukjes së tyre.

Për metodën dialektike e rëndësishme para së gjithash nuk është ajo që në një çast të dhënë duket e qëndrueshme, por që ka filluar të vyshket, porse ajo që lind dhe zhvillohet, edhe në qoftë-se në një çast të dhënë mund të duket e paqëndrueshme, sepse për metodën dialektike e pathyeshme është vetëm ajo që lind dhe zhvillohet.

> «Gjithë natyra, thotë Engelsi, duke filluar prej grimcave të saj më të vogla deri te trupat më të mëdhenj, prej kokrrës së rërës deri te dielli, prej protistit (qeliza e gjallë fillestare. — *J.St.*) dhe deri te njeriu, ndodhet në një proces të përjetshëm lindjeje dhe asgjësimi, në një proces rrjedhjeje të pandërprerë, në lëvizje dhe në ndryshim të parreshtur» *(K. Marks e F. Engels*, Veprat bot. 2 rus., vëll. 20, f. 354).

Prandaj, thotë Engelsi, dialektika «i merr sendet dhe pasqyrimet e tyre mendore kryesisht në lidhjen e tyre reciproke, në pleksjen e tyre, në lëvizjen e tyre, në lindjen dhe zhdukjen e tyre» *(F. Engels*, Anti-Dyring, bot. shqip, f. 22).

c) Në kundërshtim me metafizikën, dialektika e merr procesin e zhvillimit jo si një proces të thjeshtë rritjeje, ku ndryshimet sasiore nuk shpien në ndryshime cilësore, — por si një zhvillim të tillë, që shkon nga ndryshime pa rëndësi dhe të fshehta sasiore në ndryshi-

me të hapëta, në ndryshime rrënjësore, në ndryshime cilësore, ku ndryshimet cilësore nuk janë graduale, por të shpejta, të befasishme dhe bëhen në formë hopesh nga një gjendje në një gjendje tjetër, nuk janë të rastit, por të domosdoshme dhe vijnë si pasojë e grumbullimit të ndryshimeve të padukshme dhe graduale sasiorë.

Prandaj metoda dialektike thotë se procesi i zhvillimit nuk duhet kuptuar si një lëvizje rrethore, si një përsëritje e thjeshtë e rrugës së përshkuar, por si një lëvizje progresive, si një lëvizje hypëse, si një kalim nga një gjendje e vjetër cilësie në një gjendje të re cilësie, si një zhvillim nga e thjeshta tek e ndërlikuara, nga më e ulëta tek më e larta.

> Natyra, thotë Engelsi, është guri i provës i dialektikës, dhe shkencat e sotme natyrore, që na kanë dhënë për këtë provë një material jashtëzakonisht të pasur dhe që shtohet çdo ditë, kanë provuar kështu se, në fund të fundit, në natyrë gjithshka kryhet në mënyrë dialektike, e jo metafizike, se ajo nuk lëviz brenda një rrethi gjithnjë të njëllojtë dhe që përsëritet vazhdimisht, por jeton një histori të vërtetë. Këtu para së gjithash duhet të përmendim Darvinin, i cili i dha një grusht shumë të fortë pikëpamjes metafizike mbi natyrën, duke provuar se gjithë bota e sotme organike, bimët dhe kafshët, pra edhe njeriu, janë produkt i procesit të zhvillimit që ka vazhduar miliona vjet» (po aty, f. 22).

Duke e karakterizuar zhvillimin dialektik si një kalim nga ndryshimet e sasisë në ndryshime cilësie, Engelsi thotë:

> «Në fizikë... çdo ndryshim është një kalim i sasisë në cilësi, është pasojë e ndryshimit sasior të një sasie të caktuar lëvizjeje — të çfarëdo forme

qoftë — që e ka trupi në vetëvete ose që i vjen atij nga jashtë. Kështu, për shembull, temperatura e ujit në fillim nuk ka asnjë rëndësi për gjendjen e tij të lëngët; por kur temperatura e ujit ngrihet ose ulet, arrin një çast kur kjo gjendje kohezioni ndryshon dhe uji në një rast kthehet në avull, në rastin tjetër — në akull... Kështu, duhet një minimum i caktuar korrenti elektrik që një tel platini të fillojë të japë dritë; kështu, — çdo metal ka një temperaturë të tij shkrirjeje; kështu, çdo trup i lëngët ka pikën e tij të caktuar të ngrirjes ose të vlimit nën një presion të caktuar — me aq sa na lejojnë mjetet tona të arrijmë temperaturën përkatëse; kështu, më në fund, çdo gaz ka pikën kritike, në të cilën me një presion të caktuar dhe me një ftohje të caktuar mund të kthehet në gjendjen e tij të lëngët... Të ashtuquajturat konstante të fizikës (pikat e kalimit nga një gjendje në një gjendje tjetër — *J. St.*), të shumtën e rasteve, nuk janë gjë tjetër veçse shprehje të pikave-nyje, ku shtimi ose pakësimi (ndryshimi) i lëvizjes nga pikëpamja e sasisë shkakton një ndryshim cilësie në gjendjen e një trupi të caktuar, — ku, si pasojë, sasia kalon në cilësi» *(K. Marks* e *F. Engels*, Veprat, bot. 2 rus., vëll. 20, f. 387).

Duke u hedhur, pastaj, në kimi, Engelsi vazhdon:

«Kimia mund të quhet shkenca e ndryshimeve cilësore të trupave, të cilat bëhen nën influencën e ndryshimit të përbërjes sasiore. Këtë e dinte edhe vetë Hegeli... Të marrim oksigjenin: në qoftë se në një molekulë bashkohen tre atome, dhe jo dy, sikurse bëhet zakonisht, kemi ozonin, një trup që ndryshon krejt prej oksigjenit të zakonshëm nga era dhe nga reaksionet e tij. Dhe ç'të themi pastaj për përpjesëtimet e ndryshme, në të cilat oksigjeni bashkohet me azotin ose me squfurin: dhe

ku çdo përpjesëtim jep një trup, që nga cilësia e tij ndryshon prej gjithë trupave të tjerë!» (po aty, f. 387).

Më në fund, duke kritikuar Dyringun, i cili nuk lë gjë pa thënë kundër Hegelit dhe që, nga ana tjetër, merr fshehurazi tezën e tij të njohur, sipas së cilës kalimi nga mbretëria e botës pa ndjenja në mbretërinë e ndijimeve, nga mbretëria e botës inorganike në mbretërinë e jetës organike është një hop në një gjendje të re, Engelsi thotë:

> «Kjo është pikërisht vija nyjore hegeliane e raporteve të masës, ku shtimi ose pakësimi thjesht sasior shkakton, në pika-nyje të caktuara, *një hop cilësor*, si, për shembull, në rastin e nxehjes ose të ftohjes së ujit, ku pikat e vlimit dhe të ngrirjes janë ato nyje, në të cilat — në një presion normal — kryhet kapërcimi në një gjendje të re agregimi, ku, si pasojë, sasia shndërrohet në cilësi» (*F. Engels*, Anti-Dyring, bot. shqip, f. 44).

ç) Në kundërshtim me metafizikën, dialektika niset nga parimi se sendet e natyrës, fenomenet e natyrës kanë kontradikta të brendshme, sepse të gjitha ato kanë anën e tyre negative dhe pozitive, kanë të shkuarën dhe të ardhmen e tyre, anën e tyre që zhduket dhe atë që zhvillohet, se lufta e këtyre të kundërtave, lufta midis së vjetrës dhe së resë, midis asaj që vdes dhe asaj që lind, midis asaj që zhduket dhe asaj që zhvillohet, formon përmbajtjen e brendshme të procesit të zhvillimit, përmbajtjen e brendshme të shndërrimit të ndryshimeve të sasisë në ndryshime cilësie.

Prandaj metoda dialektike thotë se procesi i zhvillimit nga më e ulëta tek më e larta bëhet jo nëpërmjet

një evolucioni të harmonishëm të fenomeneve, por nëpermjet zbulimit të kontradiktave që kanë sendet, fenomenet, nëpërmjet «luftës» së tendencave të kundërta që veprojnë mbi bazën e këtyre kontradiktave.

> «Në kuptimin e vërtetë të fjalës, thotë Lenini, dialektika është studimi i kontradiktës *në vetë thelbin e sendeve*» (*V. I. Lenin.* Veprat, bot. 4 rus, vëll. 38. f. 249).

Dhe më poshtë:

> «Zhvillimi është «luftë» e të kundërtave» (*V. I. Lenin.* Veprat, bot. 3 rus., vëll. XIII, f. 301).

Këto janë, shkurtimisht, tiparet themelore të metodës dialektike marksiste.

Nuk është vështirë të kuptohet se sa rëndësi të madhe ka shtrirja e parimeve të metodës dialektike në studimin e jetës shoqërore, në studimin e historisë së shoqërisë, sa rëndësi të madhe ka zbatimi i këtyre parimeve në historinë e shoqërisë, në veprimtarinë praktike të partisë së proletariatit.

Në qoftë se në botë nuk ka fenomene të izoluara, në qoftë se të gjitha fenomenet janë të lidhura midis tyre dhe kondicionojnë njëri-tjetrin, atëherë është e qartë se çdo rend shoqëror dhe çdo lëvizje shoqërore në histori nuk duhet vlerësuar nga pikëpamja e «drejtësisë së amshuar» ose e ndonjë paragjykimi tjetër, siç bëjnë shpesh historianët, por nga pikëpamja e kushteve që e kanë lindur këtë rend dhe këtë lëvizje shoqërore, kushte me të cilat ata janë të lidhur.

Rendi i skllavërisë për kushtet e sotme është një gjë pa kuptim, një marrëzi e kundërnatyrshme. Rendi

i skllavërisë, kur rendi i komunës primitive ndodhet në shkatërrim e sipër, është një fenomen krejt i kuptueshëm dhe i natyrshëm, sepse shënon një hap përpara në krahasim me rendin e komunës primitive.

Kërkesa për një republikë demokratiko-borgjeze në kushtet e ekzistencës së carizmit dhe të shoqërisë borgjeze, të themi, në vitin 1905 në Rusi, ishte një kërkesë plotësisht e kuptueshme, e drejtë dhe revolucionare, sepse republika borgjeze ishte atëherë një hap përpara. Kërkesa për një republikë demokratiko-borgjeze, në kushtet tona të sotme në BRSS, është një kërkesë pa kuptim dhe kundërrevolucionare, sepse republika borgjeze në krahasim me Republikën Sovjetike është një hap prapa.

Çdo gjë varet nga kushtet, nga vendi dhe nga koha.

Kuptohet se pa një trajtim të tillë *historik* të fenomeneve shoqërore nuk mund të ekzistojë dhe të zhvillohet shkenca e historisë, sepse vetëm një trajtim i tillë nuk e lë shkencën e historisë të bëhet një kaos gjërash të rastit dhe një grumbull gabimesh të rënda.

Më tej. Në qoftë se bota ndodhet në lëvizje dhe në zhvillim të parreshtur, në qoftë se zhdukja e së vjetrës dhe rritja e së resë është ligj i zhvillimit, atëherë është e qartë se nuk ka më sisteme shoqërore «të pandryshueshme», «parime të amshuara» të pronës private dhe të shfrytëzimit, «ide të amshuara» të nënshtrimit të fshatarëve ndaj çifligarëve, të punëtorëve ndaj kapitalistëve.

Pra, rendi kapitalist mund të zëvendësohet me rendin socialist, ashtu sikurse rendi kapitalist zëvendësoi dikur rendin feudal.

Pra, duhet të orientohemi jo nga ato shtresa të shoqërisë që nuk zhvillohen më, megjithëse ato sot për sot

janë forca mbizotëruese, por nga ato shtresa që zhvillohen, që kanë të ardhme, megjithëse sot për sot ato nuk janë forcë mbizotëruese.

Më 1880-90, në kohën kur marksistët luftonin kundër narodnikëve, në Rusi proletariati ishte një pakicë shumë e vogël në krahasim me fshatarët individualë, që përbënin shumicën dërmuese të popullsisë. Por proletariati, si klasë, zhvillohej, kurse fshatarësia, si klasë, shthurej. Dhe pikërisht sepse proletariati zhvillohej, si klasë, marksistët orientoheshin nga proletariati. Dhe ata nuk u gabuan, sepse, siç dihet, proletariati, nga një forcë e vogël që ishte, u rrit e u bë një forcë historike dhe politike e dorës së parë.

Pra, për të mos gabuar në politikë, duhet shikuar përpara, e jo prapa.

Më tej. Në qoftë se kalimi nga ndryshimet e ngadalshme të sasisë në ndryshime të shpejta dhe të menjëhershme cilësie është ligj i zhvillimit, atëherë është e qartë se përmbysjet revolucionare, të kryera nga klasat e shtypura, janë një fenomen fare i natyrshëm dhe i pashmangshëm.

Pra, kalimi nga kapitalizmi në socializëm dhe çlirimi i klasës punëtore nga zgjedha kapitaliste mund të bëhet jo me anë ndryshimesh të ngadalshme, jo me anë reformash, por vetëm me anën e ndryshimit cilësor të rendit kapitalist, me anën e revolucionit.

Pra, për të mos gabuar në politikë, duhet të jesh revolucionar, e jo reformist.

Më tej. Në qoftë se zhvillimi bëhet nëpërmjet zbulimit të kontradiktave të brendshme, nëpërmjet përpjekjesh të forcave të kundërta mbi bazën e këtyre kontradiktave, me qëllim që të kapërcehen këto kontradikta, atëherë është e qartë se lufta e klasës e proletariatit

është një fenomen fare i natyrshëm dhe i pashmangshëm.

Pra, nuk duhen mbuluar kontradiktat e regjimit kapitalist, por duhen zbuluar dhe duhen nxjerrë në shesh ato, nuk duhet shuar lufta e klasave, por duhet shpënë ajo deri në fund.

Pra, për të mos gabuar në politikë, duhet bërë një politikë e papajtueshme proletare klase, e jo një politikë reformiste harmonie midis interesave të proletariatit dhe të borgjezisë, jo një politikë oportuniste «integrimi» të kapitalizmit në socializëm.

Kështu qëndron puna me metodën dialektike marksiste, të zbatuar në jetën shoqërore, në historinë e shoqërisë.

Përsa i përket materializmit filozofik marksist, ky është në themel krejt e kundërta e idealizmit filozofik.

2) **Materializmi filozofik marksist** karakterizohet nga këto tipare themelore:

a) Në kundërshtim me idealizmin, që e merr botën si mishërim të «idesë absolute», të «frymës universale», të «ndërgjegjes», — materializmi filozofik i Marksit niset nga parimi se bota nga vetë natyra e saj është *materiale*, se fenomenet e shumta në botë janë aspektet e ndryshme të materies që lëviz, se lidhja reciproke dhe kondicionimi reciprok i fenomeneve, që ka zbuluar metoda dialektike, janë ligjet objektive të zhvillimit të materies që lëviz, se bota zhvillohet sipas ligjeve të lëvizjes së materies dhe nuk ka nevojë për asnjë «frymë universale».

> «Botëkuptimi materialist, thotë Engelsi, nuk është gjë tjetër veçse të kuptuarit e natyrës ashtu siç është, pa i shtuar asgjë nga jashtë» (*K. Marks* e *F. Engels*, Veprat, bot, 2 rus., vëll. 20, f. 513).

Duke folur për pikëpamjen materialiste të filozofit të kohërave të vjetra, Heraklitit, sipas të cilit «bota është një e tërë, nuk është krijuar prej asnjë perëndie dhe prej asnjë njeriu, por ka qenë, është dhe do të jetë përjetë një zjarr i gjallë që ndizet e shuhet sipas ligjesh të caktuara», — Lenini thotë: «Një paraqitje shumë e mirë e parimeve të materializmit dialektik» (*V. I. Lenin*, Veprat, bot. 4 rus., vëll. 38, f. 347).

b) Në kundërshtim me idealizmin, që thotë se realisht ekziston vetëm ndërgjegjja jonë, se bota materiale, qenja, natyra ekziston vetëm në ndërgjegjen tonë, në ndijimet, në përfytyrimet dhe në konceptet tona, — materializmi filozofik marksist niset nga parimi se materia, natyra, qenja është realiteti objektiv, që ekziston jashtë ndërgjegjes dhe pavarësisht nga ndërgjegjja, se materia është primare, meqenëse ajo është burimi i ndijimeve, i përfytyrimeve, i ndërgjegjes, kurse ndërgjegjja është sekondare, derivate, meqenëse ajo është pasqyrimi i materies, pasqyrimi i qenjes, se mendimi është një produkt i materies, që ka arritur në zhvillimin e saj një shkallë të lartë përsosmërie, dhe pikërisht — produkt i trurit, kurse truri është organi i të menduarit, se prandaj mendimin nuk mund ta ndajmë nga materia, në qoftë se nuk duam të biem në një gabim të rëndë.

> «Çështja më e lartë e gjithë filozofisë, thotë Engelsi, është çështja e raportit midis mendimit dhe qenjes, shpirtit dhe natyrës... Sipas përgjegjes që i jepnin kësaj pyetjeje, filozofët ndaheshin në dy kampe të mëdha. Ata që thoshin se shpirti ka ekzistuar përpara natyrës... përbënin kampin e idealizmit. Kurse ata që e konsideronin si primare natyrën, bënin pjesë në shkollat

e ndryshme të *materializmit*» (*K. Marks e F. Engels*, Vepra të zgjedhura në dy vëllime, bot. shqip. vëll. II. f. 348-349).

Dhe më poshtë:

«Bota materiale, e perceptuar prej shqisëve, në të cilën bëjmë pjesë edhe ne vetë, është e vetmja botë reale... Ndërgjegjja, mendimi ynë, sado mbishqisorë që të na duken, janë vetëm produkt i një organi material, trupor, i trurit. Materia nuk është një prodhim i shpirtit, por shpirti s'është gjë tjetër, veçse prodhimi më i lartë i materies» (po aty, f. 351).

Duke folur për çështjen e materies dhe të mendimit, Marksi thotë:

«*Nuk mund të ndahet mendimi nga materia që mendon.* Materia është subjekti i të gjitha ndryshimeve» (*K. Marks*, Vepra të zgjedhura. bot. rus., vëll. I, f. 302).

Duke karakterizuar materializmin filozofik marksist, Leninì thotë:

«Materializmi në përgjithësi pranon qenjen reale objektive (materien), të pavarur nga ndërgjegjja, nga ndijimi, nga eksperienca... Ndërgjegjja... është vetëm pasqyrimi i qenjes, në rastin më të mirë një pasqyrim i saj përafërsisht i saktë (adekuat, me saktësi ideale)» (*V. I. Lenin*, «Materializmi dhe empiriokriticizmi», bot. shqip, f. 274).

Dhe më tej:

— «Materia është ajo që, duke vepruar mbi shqiset tona, prodhon ndijimin, materia është

një realitet objektiv që na jepet në ndijimet.: Materia, natyra, qenja, fizikja janë primare, kurse shpirti, ndërgjegjja, ndijimi, psikikja — sekondare» (po aty, f. 115-116).

— «Tabloja e botës është një tablo që tregon se si materia lëviz dhe se si «*materia mendon*»» (po aty, f. 298).

— «Truri është organi i të menduarit» (po aty, f. 122).

c) Në kundërshtim me idealizmin, që vë në dyshim mundësinë e njohjes së botës dhe të ligjeve të saj, që nuk beson në saktësinë e njohurive tona, që nuk pranon të vërtetën objektive dhe që thotë se bota është plot me «sende në vetëvete», të cilat shkenca nuk mund t'i njohë kurrë, — materializmi filozofik marksist niset nga parimi se bota dhe ligjet e saj mund të njihen fare mirë, se njohuritë tona mbi ligjet e natyrës, të provuara nga eksperienca, nga praktika, janë njohuri të sakta, që kanë vlerën e të vërtetave objektive, se në botë nuk ka sende që nuk mund të njihen, por ka vetëm sende që nuk janë njohur akoma, por që do të zbulohen dhe do të njihen me forcat e shkencës dhe të praktikës.

Duke kritikuar tezën e Kantit dhe të idealistëve të tjerë, që thonë se bota nuk mund të njihet, se «sendet në vetëvete» nuk mund të njihen, dhe duke mbrojtur tezën e njohur të materializmit, që thotë se njohuritë tona janë të sakta, Engelsi shkruan:

«Përgënjeshtrimi më vendimtar i këtyre trillimeve filozofike, si edhe i gjithë të tjerave, është praktika, pikërisht eksperimenti dhe industria. Po të mund të provojmë saktësinë e kuptimit tonë mbi një fenomen të natyrës, duke e krijuar ne vetë, duke e nxjerrë nga kushtet e tij, dhe, për më tepër, duke e bërë të na shër-

bejë për qëllimet tona, atëherë ka marrë fund teza e Kantit, sipas së cilës «sendi në vetëvete» nuk mund të kapet. Lëndët kimike, që formohen në trupat bimorë dhe shtazorë, mbeteshin «sende në vetëvete», derisa kimia organike filloi t'i prodhojë njërën pas tjetrës; që atëherë «sendi në vetëvete» u bë send për ne, si, për shembull, alizarina, ngjyra e garancës, që ne nuk e nxjerrim më nga rrënjët e garancës, e cila rritet nëpër fusha, por më lirë dhe në mënyrë shumë më të thjeshtë nga katrani i qymyrgurit. Sistemi diellor i Kopernikut, gjatë treqind vjetëve, mbeti një hipotezë, në shkallën më të lartë e mundshme, por, megjithatë, një hipotezë. Por kur Leverjé, në bazë të të dhënave të këtij sistemi, jo vetëm që vërtetoi se duhej të ekzistonte edhe një planet i panjohur deri atëherë, por edhe përcaktoi me anë llogaritjesh vendin që ky planet zinte në hapësirën qiellore; dhe kur më vonë Gale e zbuloi efektivisht këtë planet, sistemi i Kopernikut u provua (*K. Marks e F. Engels*, Vepra të zgjedhura në dy vëllime, bot. shqip, vëll. II, f. 349-350).

Duke akuzuar për fideizëm Bogdanovin, Bazarovin, Jushkeviçin dhe partizanë të tjerë të Mahut dhe duke mbrojtur tezën e njohur të materializmit, sipas së cilës njohuritë tona shkencore mbi ligjet objektive të natyrës janë të sakta, se ligjet e shkencës janë një e vërtetë objektive, Lenini thotë:

«Fideizmi i sotëm nuk e hedh poshtë aspak shkencën; ai hedh poshtë vetëm «pretendimet e tepruara» të shkencës, pikërisht pretendimin se ajo është një e vërtetë objektive. Në qoftë se ekziston e vërteta objektive (siç mendojnë materialistët), në qoftë se vetëm shkencat natyrore, duke pasqyruar botën e jashtme në «eksperiencën» e njeriut, mund të na japin të

vërtetën objektive, atëherë çdo fideizëm bie patjetër poshtë» (*Lenin*, «Materializmi dhe empiriokriticizmi», bot. shqip, f. 97).

Këto janë shkurtimisht tiparet karakteristike të materializmit filozofik marksist.

Kuptohet lehtë se sa rëndësi të madhe ka shtrirja e parimeve të materializmit filozofik në studimin e jetës shoqërore, në studimin e historisë së shoqërisë, sa rëndësi të madhe ka zbatimi i këtyre parimeve në historinë e shoqërisë, në veprimtarinë praktike të partisë së proletariatit.

Në qoftë se lidhja e fenomeneve të natyrës dhe kondicionimi i tyre reciprok janë ligje objektive të zhvillimit të natyrës, atëherë nga kjo del se edhe lidhja e kondicionimi reciprok i fenomeneve të jetës shoqërore nuk janë një gjë e rastit, por janë ligje objektive të zhvillimit të shoqërisë.

Pra, jeta shoqërore, historia e shoqërisë nuk është më një grumbull «gjërash të rastit», sepse historia e shoqërisë bëhet një zhvillim i shoqërisë në bazë ligjesh objektive të caktuara, kurse studimi i historisë së shoqërisë bëhet një shkencë.

Pra, veprimtaria praktike e partisë së proletariatit duhet të bazohet jo në dëshirat e mira të «njerëzve të shquar», jo në kërkesat e «arësyes», të «moralit të përgjithshëm» etj., por në ligjet objektive të zhvillimit të shoqërisë, në studimin e këtyre ligjeve.

Më tej. Në qoftë se bota mund të njihet dhe njohuritë tona mbi ligjet e zhvillimit të natyrës janë njohuri të sakta, që kanë vlerën e së vërtetës objektive, atëherë nga kjo del se edhe jeta shoqërore, zhvillimi i shoqërisë mund të njihet dhe të dhënat e shkencës mbi

ligjet e zhvillimit të shoqërisë janë të dhëna të sakta që kanë vlerën e të vërtetave objektive.

Pra, shkenca mbi historinë e shoqërisë, megjithëse fenomenet e jetës shoqërore janë shumë të ndërlikuara, mund të bëhet një shkencë aq e saktë, sa edhe, të themi, biologjia, një shkencë që të jetë e aftë t'i përdorë ligjet e zhvillimit të shoqërisë për t'i zbatuar në praktikë.

Pra, në veprimtarinë e saj praktike partia e proletariatit nuk duhet të udhëhiqet nga motive të rastit, por nga ligjet e zhvillimit të shoqërisë, nga konkluzionet praktike që dalin prej këtyre ligjeve.

Pra, socializmi nga ëndërr për një të ardhme më të mirë të njerëzimit bëhet shkencë.

Pra, lidhja e shkencës me veprimtarinë praktike, lidhja e teorisë me praktikën, uniteti i tyre duhet të jetë yll karvani për partinë e proletariatit.

Më tej. Në qoftë se natyra, qenja, bota materiale, është primare, dhe ndërgjegjja, të menduarit, është sekondare, derivate, në qoftë se bota materiale është një realitet objektiv, që ekziston pavarësisht nga ndërgjegjja e njerëzve, dhe ndërgjegjja është pasqyrimi i këtij realiteti objektiv, atëherë nga kjo del se edhe jeta materiale e shoqërisë, qenja e saj është primare, kurse jeta e saj shpirtërore është sekondare, derivate, se jeta materiale e shoqërisë është një realitet objektiv që ekziston pavarësisht nga vullneti i njerëzve, kurse jeta shpirtërore e shoqërisë është pasqyrimi i këtij realiteti objektiv, pasqyrimi i qenjes.

Pra, burimi i formimit të jetës shpirtërore të shoqërisë, burimi i prejardhjes së ideve shoqërore, teorive shoqërore, pikëpamjeve politike, institucioneve politike duhet kërkuar jo në vetë idetë, teoritë, pikëpamjet, institucionet politike, por në kushtet e jetës materiale të

shoqërisë, në qenjen shoqërore, pasqyrim i së cilës janë këto ide, teori, pikëpamje etj.

Pra, në qoftë se në periudha të ndryshme të historisë së shoqërisë vihen re ide, teori, pikëpamje të ndryshme shoqërore, institucione të ndryshme politike, në qoftë se në rendin e skllavërisë kemi disa ide, teori, pikëpamje, institucione politike, në feudalizëm kemi të tjera, në kapitalizëm të tjera akoma, kjo nuk shpjegohet me «natyrën», me «vetitë» e vetë ideve, teorive, pikëpamjeve, institucioneve politike, por me kushtet e ndryshme të jetës materiale të shoqërisë në periudha të ndryshme të zhvillimit shoqëror.

Si të jetë qenja e shoqërisë, si të jenë kushtet e jetës materiale të shoqërisë, — ashtu janë edhe idetë, teoritë, pikëpamjet politike, institucionet politike.

Në lidhje me këtë Marksi thotë:

> «Nuk është ndërgjegjja e njerëzve që përcakton qenjen e tyre, por, përkundrazi, qenja e tyre shoqërore përcakton ndërgjegjen e tyre» (*K. Marks* e *F. Engels*, Vepra të zgjedhura në dy vëllime, bot. shqip, vëll. I, f. 336).

Pra, për të mos gabuar në politikë dhe për të mos u dhënë pas ëndrrash të kota, partia e proletariatit, në veprimtarinë e saj, duhet të niset jo nga «parimet» abstrakte të «arësyes njerëzore», por nga kushtet konkrete të jetës materiale të shoqërisë, që është forca vendimtare e zhvillimit shoqëror, duhet të niset jo nga dëshirat e mira të «njerëzve të mëdhenj», por nga nevojat reale të zhvillimit të jetës materiale të shoqërisë.

Falimentimi i utopistëve, duke përfshirë këtu edhe narodnikët, anarkistët, eserët, shpjegohet, përveç të tje-

rave, me faktin se ata nuk pranonin që kushtet e jetës materiale të shoqërisë lozin rolin e dorës së parë në zhvillimin e shoqërisë dhe, duke rënë në idealizëm, veprimtarinë e tyre praktike e bazonin jo në nevojat e zhvillimit të jetës materiale të shoqërisë, por pavarësisht nga to dhe në kundërshtim me to, — e bazonin atë në «plane ideale» dhe në «projekte të përgjithshme», të shkëputura nga jeta reale e shoqërisë.

Forca dhe vitaliteti i marksizëm-leninizmit qëndron në faktin se marksizëm-leninizmi, në veprimtarinë e tij praktike, mbështetet pikërisht në nevojat e zhvillimit të jetës materiale të shoqërisë, pa u shkëputur kurrë nga jeta reale e shoqërisë.

Por nga fjalët e Marksit nuk del se idetë, teoritë shoqërore, pikëpamjet politike, institucionet politike nuk kanë rëndësi në jetën e shoqërisë, se ato nuk ushtrojnë ndikim mbi qenjen shoqërore, mbi zhvillimin e kushteve materiale të jetës së shoqërisë. Ne këtu folëm deri tani mbi *prejardhjen* e ideve, teorive, pikëpamjeve shoqërore, institucioneve politike, mbi *lindjen* e tyre, thamë se jeta shpirtërore e shoqërisë është pasqyrimi i kushteve të jetës materiale të shoqërisë. Sa për *rëndësinë* e ideve, teorive, pikëpamjeve shoqërore, institucioneve politike, sa për *rolin* e tyre në histori, materializmi historik jo vetëm që nuk e mohon, por, përkundrazi, e nënvizon rolin dhe rëndësinë e tyre të madhe në jetën e shoqërisë, në historinë e shoqërisë.

Idetë dhe teoritë shoqërore mund të jenë të ndryshme. Ka ide dhe teori të vjetra, të cilave u ka shkuar koha dhe që u shërbejnë interesave të forcave të vjetra të shoqërisë. Rëndësia e tyre qëndron në faktin se ato e frenojnë zhvillimin e shoqërisë, përparimin e saj. Ka ide dhe teori të reja, përparimtare, që u shërbejnë interesa-

ve të forcave përparimtare të shoqërisë. Rëndësia e tyre qëndron në faktin se ato e lehtësojnë zhvillimin e shoqërisë, përparimin e saj, dhe sa më saktë të pasqyrojnë nevojat e zhvillimit të jetës materiale të shoqërisë, aq më tepër shtohet rëndësia e tyre

Idetë dhe teoritë e reja shoqërore lindin vetëm atëherë kur zhvillimi i jetës materiale të shoqërisë ka shtruar përpara shoqërisë detyra të reja. Por, pasi lindin, ato bëhen një forcë shumë e rëndësishme që lehtëson zgjidhjen e detyrave të reja, të shtruara nga zhvillimi i jetës materiale të shoqërisë, që lehtëson përparimin e shoqërisë. Pikërisht këtu duket rëndësia tepër e madhe organizuese, mobilizuese dhe transformuese e ideve të reja, e teorive të reja, e pikëpamjeve të reja politike, e institucioneve të reja politike. Idetë dhe teoritë e reja shoqërore lindin pikërisht sepse ato i duhen shoqërisë, sepse pa veprimin e tyre organizues, mobilizues dhe transformues, *nuk mund* të zgjidhen detyrat e ngutshme të zhvillimit të jetës materiale të shoqërisë. Pasi lindin në bazë të detyrave të reja, që ka shtruar zhvillimi i jetës materiale të shoqërisë, idetë dhe teoritë e reja shoqërore çajnë rrugën, bëhen pasuri e masave popullore, i mobilizojnë këto masa, i organizojnë kundër forcave të vjetra të shoqërisë dhe, në këtë mënyrë, lehtësojnë përmbysjen e forcave të vjetra të shoqërisë, që frenojnë zhvillimin e jetës materiale të shoqërisë.

Kështu idetë, teoritë shoqërore, institucionet politike, pasi lindin në bazë të detyrave të ngutshme të zhvillimit të jetës materiale të shoqërisë, të zhvillimit të qenjes shoqërore, — ato vetë ushtrojnë, pastaj, influencën e tyre mbi qenjen shoqërore, mbi jetën materiale të shoqërisë, duke krijuar kushtet e domosdoshme për ta çuar deri në fund zgjidhjen e detyrave të ngutshme

të jetës materiale të shoqërisë dhe për ta bërë të mundshëm zhvillimin e saj të mëtejshëm.

Në lidhje me këtë Marksi thotë:

> «Teoria bëhet një forcë materiale, sapo ajo bën për vete masat» (*K. Marks e F. Engels*, Veprat, bot. 2 rus., vëll. 1, f. 422).

Pra, që të ketë mundësi të veprojë mbi kushtet e jetës materiale të shoqërisë dhe të shpejtojë zhvillimin e tyre, të shpejtojë përmirësimin e tyre, partia e proletariatit duhet të mbështetet në një teori të tillë shoqërore, në një ide të tillë shoqërore, e cila të pasqyrojë drejt nevojat e zhvillimit të jetës materiale të shoqërisë dhe të jetë, pra, e aftë t'i vërë në lëvizje masat e gjera të popullit, t'i mobilizojë ato dhe t'i organizojë në ushtrinë e madhe të partisë së proletariatit, të gatshme të thyejë forcat reaksionare dhe t'u hapë rrugën forcave përparimtare të shoqërisë.

Falimentimi i «ekonomistëve» dhe i menshevikëve shpjegohet, midis së tjerash, me faktin se ata nuk e pranonin rolin mobilizues, organizues dhe transformues të teorisë pararojë, të idesë pararojë dhe, duke rënë në materializëm vulgar, e reduktonin rolin e tyre pothuajse në zero, dhe, si pasojë, e dënonin partinë të mbetej në pasivitet, të kalbej.

Forca dhe vitaliteti i marksizëm-leninizmit qëndron në faktin se ai mbështetet në një teori pararojë, që pasqyron drejt nevojat e zhvillimit të jetës materiale të shoqërisë, e ngre teorinë në lartësinë e duhur dhe e quan për detyrë të përdorë deri në fund forcën e saj organizuese, mobilizuese dhe transformuese.

Kështu e zgjidh materializmi historik çështjen e

raportit midis qenjes shoqërore dhe ndërgjegjes shoqërore, midis kushteve të zhvillimit të jetës materiale dhe zhvillimit të jetës shpirtërore të shoqërisë.

3) Materializmi historik.

Mbetet për t'u sqaruar çështja: ç'duhet kuptuar, nga pikëpamja e materializmit historik, me «kushte të jetës materiale të shoqërisë», që përcaktojnë, në fund të fundit, fizionominë e shoqërisë, idetë e saj, pikëpamjet e saj, institucionet e saj politike etj.

Po ç'janë, në të vërtetë, këto «kushte të jetës materiale të shoqërisë», cilat janë tiparet e tyre dalluese?

S'ka dyshim se në nocionin «kushte të jetës materiale të shoqërisë» hyn, para së gjithash, natyra që rrethon shoqërinë, ambienti gjeografik që është një nga kushtet e domosdoshme dhe të përhershme të jetës materiale të shoqërisë dhe, natyrisht, ndikon mbi zhvillimin e shoqërisë. Cili është roli i ambientit gjeografik në zhvillimin e shoqërisë? Mos është vallë ambienti gjeografik ajo forcë kryesore që përcakton fizionominë e shoqërisë, karakterin e rendit shoqëror të njerëzve, kalimin nga një rend në një tjetër?

Materializmi historik i përgjigjet kësaj pyetjeje negativisht.

Ambienti gjeografik, pa dyshim, është një nga kushtet e përhershme dhe të domosdoshme të zhvillimit të shoqërisë dhe ai, natyrisht, ndikon mbi zhvillimin e shoqërisë, — e shpejton ose e ngadalëson rrjedhën e zhvillimit të shoqërisë. Por ndikimi i tij nuk është një ndikim *përcaktues*, sepse ndryshimet dhe zhvillimi i shoqërisë bëhen shumë më shpejt se sa ndryshimet dhe zhvillimi i ambientit gjeografik. Gjatë trimijë vjetëve në Evropë kanë arritur të ndryshohen

tri rende të ndryshme shoqërore: rendi i komunës primitive, rendi i skllavërisë, rendi feudal, kurse në pjesën lindore të Evropës, në BRSS, janë ndryshuar bile katër rende shoqërore. Ndërkaq, gjatë po kësaj kohe, kushtet gjeografike në Evropë ose nuk kanë ndryshuar fare, ose kanë ndryshuar aq pak, saqë gjeografia nuk i përmend fare. Dhe kjo kuptohet. Për ndryshime pak a shumë me rëndësi të ambientit gjeografik duhen miliona vjet, kurse për ndryshime shumë të mëdha në rendin shoqëror të njerëzve mjaftojnë disa qindra vjet ose nja dymijë vjet.

Por nga kjo del se ambienti gjeografik nuk mund të jetë shkaku kryesor, shkaku *përcaktues* i zhvillimit shoqëror, sepse një gjë që nuk ndryshon pothuajse fare gjatë dhjetëra mijëra vjetësh, nuk mund të jetë shkaku kryesor i zhvillimit të asaj që pëson ndryshime rrënjësore gjatë qindra vjetësh.

Pastaj, nuk ka dyshim se shtimi i popullsisë, kjo apo ajo dendësi e popullsisë, hyjnë gjithashtu në nocionin «kushte materiale të jetës së shoqërisë», sepse njerëzit janë një element i domosdoshëm i kushteve të jetës materiale të shoqërisë dhe pa një minimum të caktuar njerëzish nuk mund të ketë asnjë jetë materiale të shoqërisë. Mos është vallë shtimi i popullsisë ajo forcë kryesore që përcakton karakterin e rendit shoqëror të njerëzve?

Materializmi historik i përgjigjet edhe kësaj pyetjeje negativisht.

Natyrisht, shtimi i popullsisë ndikon mbi zhvillimin e shoqërisë, lehtëson ose ngadalëson zhvillimin e shoqërisë, por nuk mund të jetë forca kryesore e zhvillimit të shoqërisë, dhe ndikimi i tij mbi zhvillimin e shoqërisë nuk mund të jetë ndikim *përcaktues*, sepse në

vetëvete shtimi i popullsisë nuk na jep kyçin për të shpjeguar pse një rend shoqëror i caktuar zëvendësohet pikërisht nga ky rend i ri, e jo nga ndonjë tjetër, pse rendi i komunës primitive zëvendësohet pikërisht nga rendi i skllavërisë, rendi i skllavërisë nga rendi feudal, rendi feudal nga rendi borgjez, e jo nga ndonjë rend tjetër.

Sikur shtimi i popullsisë të ishte forca përcaktuese e zhvillimit shoqëror, një dendësi më e madhe e popullsisë duhej medoemos të sillte me vete një tip respektivisht më të lartë të rendit shoqëror. Mirëpo, në të vërtetë, një gjë të tillë nuk e vëmë re. Në Kinë dendësia e popullsisë është katër herë më e madhe se në SHBA, mirëpo SHBA qëndrojnë më lart se Kina nga pikëpamja e zhvillimit shoqëror, sepse në Kinë sundon akoma rendi gjysmëfeudal, kurse SHBA prej kohe kanë arritur fazën më të lartë të zhvillimit të kapitalizmit. Në Belgjikë dendësia e popullsisë është 19 herë më e madhe se në SHBA dhe 26 herë më e madhe se në BRSS, mirëpo SHBA qëndrojnë më lart se Belgjika nga pikëpamja e zhvillimit shoqëror, kurse nga BRSS Belgjika ka mbetur prapa një epokë të tërë historike, sepse në Belgjikë sundon rendi kapitalist, kurse në BRSS i është dhënë fund kapitalizmit dhe është vendosur rendi socialist.

Por nga kjo del se shtimi i popullsisë nuk është dhe nuk mund të jetë forca kryesore e zhvillimit të shoqërisë, që *përcakton* karakterin e rendit shoqëror, fizionominë e shoqërisë.

a) Atëherë cila është forca kryesore, në sistemin e kushteve të jetës materiale të shoqërisë, që përcakton fizionominë e shoqërisë, karakterin e rendit shoqëror, zhvillimin e shoqërisë nga një rend në një tjetër?

Si forcë të tillë materializmi historik quan *mëny-*

rën e sigurimit të mjeteve të jetesës të domosdoshme për ekzistencën e njerëzve, *mënyrën e prodhimit të të mirave materiale* — të ushqimit, të veshmbathjes, të banesave, të lëndëve djegëse; të veglave të prodhimit etj., të domosdoshme që shoqëria të mund të jetojë e të zhvillohet.

Për të jetuar duhet të kesh ushqim, veshmbathje, banesë, lëndë djegëse etj., për t'i pasur këto të mira materiale duhet t'i prodhosh ato, dhe për t'i prodhuar ato duhet të kesh vegla prodhimi, me anën e të cilave njerëzit prodhojnë ushqimin, veshmbathjen, banesën, lëndët djegëse etj., duhet të dish t'i prodhosh këto vegla, duhet të dish t'i përdorësh këto vegla.

Veglat e prodhimit, me anën e të cilave prodhohen të mirat materiale, *njerëzit*, që i vënë në lëvizje veglat e prodhimit dhe që realizojnë prodhimin e të mirave materiale në saje të një farë *eksperience në prodhim* dhe *shprehive në punë*, — të gjitha këto elemente së bashku përbëjnë *forcat prodhuese* të shoqërisë.

Por forcat prodhuese përbëjnë vetëm një anë të prodhimit, një anë të mënyrës së prodhimit, që shpreh qëndrimin e njerëzve ndaj sendeve dhe forcave të natyrës, që përdoren për të prodhuar të mira materiale. Ana tjetër e prodhimit, ana tjetër e mënyrës së prodhimit janë marrëdhënjet e njerëzve midis tyre në procesin e prodhimit, janë *marrëdhënjet e prodhimit* midis njerëzve. Njerëzit luftojnë kundër natyrës dhe e përdorin natyrën për të prodhuar të mira materiale jo të izoluar nga njëri-tjetri, jo të veçuar e të shkëputur nga njëri-tjetri, por së bashku, me grupe, me shoqëri. Prandaj prodhimi është kurdoherë dhe në çdo rrethanë prodhim *shoqëror*. Duke realizuar prodhimin e të mirave materiale, njerëzit vendosin midis tyre këto apo ato

marrëdhënje brenda prodhimit, këto apo ato marrëdhënje prodhimi. Këto marrëdhënje mund të jenë marrëdhënje bashkëpunimi dhe ndihme reciproke midis njerëzish të lirë nga shfrytëzimi, ato mund të jenë marrëdhënje sundimi dhe nënshtrimi, ato mund të jenë, më në fund, marrëdhënje tranzitore nga një formë marrëdhënjesh prodhimi në një formë tjetër. Por, cilido qoftë karakteri i marrëdhënjeve të prodhimit, ato — kurdoherë dhe në çdo rend — janë një element po aq i domosdoshëm i prodhimit, sa edhe forcat prodhuese të shoqërisë.

> «Në prodhim, thotë Marksi, njerëzit veprojnë jo vetëm mbi natyrën, por edhe mbi njëri-tjetrin. Ata nuk mund të prodhojnë pa u bashkuar në një farë mënyre për veprimtari të përbashkët dhe për të këmbyer me njëri-tjetrin veprimtarinë e tyre. Për të prodhuar, njerëzit hyjnë në lidhje dhe marrëdhënje të caktuara, dhe vetëm nëpërmjet këtyre lidhjeve dhe marrëdhënjeve shoqërore kryhet veprimi i tyre mbi natyrën, bëhet prodhimi» (*K. Marks* e *F. Engels*, Vepra të zgjedhura në dy vëllime, bot. shqip, vëll. I, f. 74).

Pra, prodhimi, mënyra e prodhimit përfshin si forcat prodhuese të shoqërisë, ashtu edhe marrëdhënjet e njerëzve në prodhim, duke qenë, në këtë mënyrë, mishërimi i unitetit të tyre në procesin e prodhimit të të mirave materiale.

b) *Veçoria e parë* e prodhimit është se ai nuk ngec kurrë në një pikë të caktuar për një kohë të gjatë dhe është kurdoherë në gjendje ndryshimi dhe zhvillimi, dhe ndryshimet në mënyrën e prodhimit shkaktojnë patjetër ndryshimin e gjithë rendit shoqëror, të ideve shoqërore, të pikëpamjeve politike, të institucioneve politike, —

shkaktojnë transformimin e gjithë sistemit shoqëror dhe politik. Në etapa të ndryshme të zhvillimit njerëzit përdorin mënyra të ndryshme prodhimi, ose, po të shprehemi më thjesht, kanë mënyra të ndryshme jetese. Në komunën primitive ka një mënyrë prodhimi, në skllavërinë ka një mënyrë tjetër prodhimi, në feudalizëm ka një mënyrë të tretë prodhimi, e kështu me radhë. Në përputhje me këto ndryshime ndryshojnë edhe rendi shoqëror i njerëzve, jeta e tyre shpirtërore, pikëpamjet e tyre, institucionet e tyre politike.

Si të jetë mënyra e prodhimit të një shoqërie, — ashtu është në përgjithësi edhe shoqëria vetë, ashtu janë idetë dhe teoritë e saj, pikëpamjet e institucionet e saj politike.

Ose, ta themi më thjesht: si të jetë mënyra e jetesës së njerëzve, — ashtu është edhe mënyra e tyre e të menduarit.

Kjo do të thotë se historia e zhvillimit të shoqërisë është, para së gjithash, historia e zhvillimit të prodhimit, historia e mënyrave të prodhimit, që zëvendësojnë njëra-tjetrën gjatë shekujve, historia e zhvillimit të forcave prodhuese dhe të marrëdhënjeve të njerëzve në prodhim.

Pra, historia e zhvillimit shoqëror është njëkohësisht historia e vetë prodhuesve të të mirave materiale, historia e masave punonjëse, që janë forcat kryesore të procesit të prodhimit dhe që realizojnë prodhimin e të mirave materiale të domosdoshme për ekzistencën e shoqërisë.

Pra, shkenca historike, në don të jetë një shkencë e vërtetë, nuk mund ta kufizojë më historinë e zhvillimit të shoqërisë me veprimet e mbretërve dhe të prijësve ushtarakë, me veprimet e «pushtuesve» dhe «nën-

shtruesve» të shteteve, por duhet, para së gjithash, të merret me historinë e prodhuesve të të mirave materiale, me historinë e masave punonjëse, me historinë e popujve.

Pra, kyçi për të studjuar ligjet e historisë së shoqërisë nuk duhet kërkuar në kokën e njerëzve, në pikëpamjet dhe në idetë e shoqërisë, por në mënyrën e prodhimit, që praktikohet nga shoqëria në çdo periudhë të caktuar të historisë, — në ekonominë e shoqërisë.

Pra, detyra e parë e shkencës së historisë është studimi dhe zbulimi i ligjeve të prodhimit, i ligjeve të zhvillimit të forcave prodhuese dhe të marrëdhënjeve të prodhimit, i ligjeve të zhvillimit ekonomik të shoqërisë.

Pra, partia e proletariatit, në don të jetë një parti e vërtetë, duhet të pajiset, para së gjithash, me dijen e ligjeve të zhvillimit të prodhimit, ligjeve të zhvillimit ekonomik të shoqërisë.

Pra, për të mos gabuar në politikë, partia e proletariatit, si në hartimin e programit të saj ashtu edhe në veprimtarinë e saj praktike, duhet të niset, para së gjithash, nga ligjet e zhvillimit të prodhimit, nga ligjet e zhvillimit ekonomik të shoqërisë.

c) *Veçoria e dytë* e prodhimit është se ndryshimet dhe zhvillimi i tij fillojnë kurdoherë me ndryshimin dhe me zhvillimin e forcave prodhuese, para së gjithash — me ndryshimin dhe me zhvillimin e veglave të prodhimit. Pra, forcat prodhuese janë elementi më i lëvizshëm dhe më revolucionar i prodhimit. Në fillim ndryshojnë dhe zhvillohen forcat prodhuese të shoqërisë, dhe pastaj, *në lidhje* me këto ndryshime dhe *në përputhje me to*, ndryshojnë marrëdhënjet e njerëzve në prodhim, marrëdhënjet ekonomike të njerëzve. Por kjo nuk do të thotë se marrëdhënjet e prodhimit nuk ndikojnë mbi zhvillimin e forcave prodhuese dhe se këto të fu-

ndit nuk varen nga të parat. Marrëdhënjet e prodhimit, zhvillimi i të cilave varet nga zhvillimi i forcave prodhuese, ndikojnë nga ana e tyre mbi zhvillimin e forcave prodhuese, duke e shpejtuar ose duke e ngadalësuar atë. Në lidhje me këtë duhet theksuar se marrëdhënjet e prodhimit nuk munden, për një kohë shumë të gjatë, të mbeten prapa rritjes së forcave prodhuese dhe të jenë në kundërshtim me të, meqenëse forcat prodhuese mund të zhvillohen plotësisht vetëm atëherë, kur marrëdhënjet e prodhimit i përgjigjen karakterit, gjendjes së forcave prodhuese dhe i lënë fushë të lirë zhvillimit të forcave prodhuese. Prandaj, sado prapa që të mbeten marrëdhënjet e prodhimit nga zhvillimi i forcave prodhuese, shpejt a vonë ato duhet t'i përgjigjen, dhe me të vërtetë i përgjigjen, nivelit të zhvillimit të forcave prodhuese, karakterit të forcave prodhuese. Në rast të kundërt ne do të kishim një prishje rrënjësore të unitetit të forcave prodhuese dhe të marrëdhënjeve të prodhimit në sistemin e prodhimit, një ndërprerje të prodhimit në tërësi, një krizë të prodhimit, shkatërrimin e forcave prodhuese.

Shembull i mospërputhjes së marrëdhenjeve të prodhimit me karakterin e forcave prodhuese, shembull i konfliktit midis tyre, janë krizat ekonomike në vendet kapitaliste, ku prona private kapitaliste mbi mjetet e prodhimit është në mospërputhje të dukshme me karakterin shoqëror të procesit të prodhimit, me karakterin e forcave prodhuese. Rezultat i kësaj mospërputhjeje janë krizat ekonomike, që sjellin shkatërrimin e forcave prodhuese, dhe vetë kjo mospërputhje është baza ekonomike e revolucionit social, që ka për mision të shkatërrojë marrëdhënjet e sotme të prodhimit dhe të krijojë marrëdhënje të reja prodhimi që t'i përgjigjen karakterit të forcave prodhuese.

Dhe, përkundrazi, si shembull i përputhjes së plotë të marrëdhënjeve të prodhimit me karakterin e forcave prodhuese është ekonomia socialiste e BRSS, ku prona shoqërore mbi mjetet e prodhimit i përgjigjet plotësisht karakterit shoqëror të procesit të prodhimit dhe ku, pra, nuk ka as kriza ekonomike, as shkatërrim të forcave prodhuese.

Pra, forcat prodhuese nuk janë vetëm elementi më i lëvizshëm dhe më revolucionar i prodhimit. Ato janë njëkohësisht edhe elementi përcaktues i zhvillimit të prodhimit.

Si të jenë forcat prodhuese, — ashtu duhet të jenë edhe marrëdhënjet e prodhimit.

Në qoftë se gjendja e forcave prodhuese i përgjigjet pyetjes se me ç'vegla prodhimi i prodhojnë njerëzit të mirat materiale që u nevojiten, gjendja e marrëdhënjeve të prodhimit i përgjigjet pyetjes tjetër se kush i zotëron *mjetet e prodhimit* (tokën, pyjet, ujërat, pasuritë e nëntokës, lëndët e para, veglat e prodhimit, ndërtesat që duhen për prodhim, mjetet e transportit e të ndërlidhjes etj.), në duart e kujt janë mjetet e prodhimit, në duart e gjithë shoqërisë apo në duart e individëve, grupeve, klasave të veçanta, që i përdorin këto mjete prodhimi për të shfrytëzuar individë, grupe, klasa të tjera.

Ja një pasqyrë skematike e zhvillimit të forcave prodhuese që nga kohët e lashta e deri në ditët tona. Kalimi nga veglat primitive prej guri te harku dhe shigjeta dhe, në lidhje me këtë, kalimi nga mënyra e jetesës me anë të gjahut në zbutjen e kafshëve dhe në blegtorinë primitive; kalimi nga veglat prej guri te veglat prej metali (sëpata e hekurt, parmenda me pluar të hekurt etj.) dhe, në përshtatje me këtë, kalimi në rritjen e bimëve dhe në bujqësi; përmirësimi i mëtejshëm i veglave

prej metali për të përpunuar materialet, kalimi në gjyrykun e kovaçit, kalimi në prodhimin e poçerisë dhe, në përputhje me këtë, zhvillimi i zejtarisë, ndarja e zejtarisë nga bujqësia, zhvillimi i prodhimit zejtar të pavarur dhe pastaj zhvillimi i prodhimit manufakturor; kalimi nga veglat e prodhimit të zejtarëve në maqinën dhe shndërrimi i prodhimit zejtar-manufakturor në industri të mekanizuar; kalimi në sistemin e maqinave dhe lindja e industrisë së madhe moderne të mekanizuar, — kjo është pasqyra e përgjithshme, sigurisht jo e plotë, e zhvillimit të forcave prodhuese të shoqërisë gjatë historisë së njerëzimit. Kuptohet se zhvillimi dhe përmirësimi i veglave të prodhimit është bërë prej njerëzve që kanë lidhje me prodhimin, dhe jo pavarësisht nga njerëzit, — prandaj bashkë me ndryshimin dhe zhvillimin e veglave të prodhimit kanë ndryshuar dhe janë zhvilluar edhe njerëzit, si elementi më i rëndësishëm i forcave prodhuese; kanë ndryshuar dhe janë zhvilluar eksperienca e tyre në prodhim, shprehitë e tyre në punë, zotësia e tyre për të përdorur veglat e prodhimit.

Në përputhje me ndryshimin dhe zhvillimin e forcave prodhuese të shoqërisë kanë ndryshuar dhe janë zhvilluar gjatë historisë edhe marrëdhënjet e njerëzve në prodhim, marrëdhënjet e tyre ekonomike.

Historia njeh pesë tipe *kryesore* marrëdhënjesh prodhimi: komunën primitive, skllavërinë, feudalizmin, kapitalizmin, socializmin.

Në rendin e komunës primitive, baza e marrëdhënjeve të prodhimit është prona shoqërore mbi mjetet e prodhimit. Kjo, në përgjithësi, i përgjigjet karakterit të forcave prodhuese në këtë periudhë. Me vegla prej guri, me harkun e shigjetën, që dolën më vonë, ishte e pamundur që njerëzit të luftonin veç e veç kundër forcave të natyrës dhe kafshëve të egra. Për të mbledhur pemë në

pyll, për të zënë peshk në ujë, për të ndërtuar një banesë, njerëzit janë të shtërnguar të punojnë së bashku, po të mos duan të vdesin urie dhe të bëhen viktima të kafshëve të egra ose të shoqërive fqinje. Puna e përbashkët shpie në pronën e përbashkët mbi mjetet e prodhimit, ashtu edhe mbi produktet e prodhimit. Këtu nuk dinë akoma ç'është prona private mbi mjetet e prodhimit, përveç pronës personale mbi disa vegla të prodhimit, që janë njëkohësisht edhe mjete mbrojtjeje nga kafshët e egra. Këtu nuk ka shfrytëzim, nuk ka klasa.

Në rendin e skllavërisë baza e marrëdhënjeve të prodhimit është prona e pronarit të skllevërve mbi mjetet e prodhimit, si edhe mbi atë që punon në prodhim — mbi skllavin, të cilin pronari mund ta shesë, ta blejë, ta vrasë si kafshë. Këto marrëdhënje prodhimi, në përgjithësi, i përgjigjen gjendjes së forcave prodhuese në këtë periudhë. Në vend të veglave prej guri njerëzit në këtë kohë kishin vegla prej metali, në vend të ekonomisë së varfër dhe primitive të gjahut, që nuk njihte as blegtori as bujqësi, lindën blegtoria, bujqësia, zejet. ndarja e punës midis këtyre degëve të prodhimit, u krijua mundësia për të këmbyer produktet midis individëve të veçantë dhe shoqërive, mundësia e grumbullimit të pasurisë në duart e disave, grumbullimi i vërtetë i mjeteve të prodhimit në duart e një pakice, mundësia e nënshtrimit të shumicës nga pakica dhe e shndërrimit të anëtarëve të shumicës në skllevër. Këtu nuk ka më një punë të përbashkët dhe të lirë të të gjithë anëtarëve të shoqërisë në procesin e prodhimit, — këtu sundon puna e detyrueshme e skllevërve, të cilët shfrytëzohen nga pronarët që s'punojnë. Prandaj nuk ka as pronë të përbashkët mbi mjetet e prodhimit, ashtu si edhe mbi produktet e prodhimit. Atë e zëvendëson prona private.

Këtu skllavopronari është pronari i parë dhe kryesor, pronar absolut.

Të pasur dhe të varfër, shfrytëzues dhe të shfrytëzuar, njerëz që gëzojnë të gjitha të drejtat dhe njerëz pa kurrfarë të drejte, luftë e ashpër klasash midis tyre — kjo është pasqyra e rendit të skllavërisë.

Në rendin feudal baza e marrëdhënjeve të prodhimit është prona e feudalit mbi mjetet e prodhimit dhe prona e kufizuar mbi atë që punon në prodhim, — mbi bujkrobin, të cilin feudali tani nuk mund ta vrasë, por mund ta shesë e ta blejë. Krahas pronës feudale ekziston prona individuale e fshatarit dhe e zejtarit mbi veglat e prodhimit dhe mbi ekonominë e tij private të mbështetur në punën personale. Këto marrëdhënje prodhimi, në përgjithësi, i përgjigjen gjendjes së forcave prodhuese në këtë periudhë. Përmirësimi i mëtejshëm i shkrirjes dhe i përpunimit të hekurit; përhapja e plugut të hekurt dhe e tezgjahut; zhvillimi i mëtejshëm i bujqësisë, i kulturës së perimeve, i prodhimit të verës, i prodhimit të vajit; ngritja e ndërmarrjeve manufakturore krahas punishteve zejtare, — këto janë tiparet karakteristike të gjendjes së forcave prodhuese.

Forcat e reja prodhuese kërkojnë që ai që punon të ketë një farë iniciative në prodhim, të ketë prirje për punë, të ketë interes që të punojë. Prandaj feudali heq dorë nga skllavi që nuk ka interes për punën, nuk ka asnjë iniciativë në punë, dhe preferon të ketë të bëjë me bujkrobin që ka ekonominë e tij, veglat e tij të prodhimit dhe një farë interesi për punën, gjë kjo e domosdoshme që toka të punohet dhe feudalit t'i paguhet në natyrë një pjesë e prodhimit të tij.

Prona private këtu zhvillohet më tej. Shfrytëzimi është pothuajse aq i egër, sa edhe në skllavëri, — vetëm se është zbutur pak. Lufta e klasave midis shfrytëzues-

ve dhe të shfrytëzuarve përbën tiparin kryesor të rendit feudal.

Në rendin kapitalist baza e marrëdhënjeve të prodhimit është prona kapitaliste mbi mjetet e prodhimit, por jo mbi ata që punojnë në prodhim, — mbi punëtorët me mëditje, të cilët kapitalisti nuk mund as t'i vrasë, as t'i shesë, sepse ata janë të lirë nga varësia personale, por nuk kanë mjete prodhimi dhe, për të mos vdekur urie, janë të shtërnguar t'i shesin fuqinë e tyre punëtore kapitalistit dhe të mbajnë mbi zverk zgjedhën e shfrytëzimit. Krahas pronës kapitaliste mbi mjetet e prodhimit ekziston, dhe në kohët e para është shumë e përhapur, prona private e fshatarit dhe e zejtarit të çliruar nga varësia feudale mbi mjetet e prodhimit, pronë e mbështetur mbi punën personale. Në vend të punishteve të zejtarëve dhe të ndërmarrjeve manufakturore lindën fabrika dhe uzina shumë të mëdha, të pajisura me maqina. Në vend të çifliqeve feudale, që punoheshin nga fshatarët me vegla primitive prodhimi, lindën ekonomi të mëdha kapitaliste, të drejtuara në bazë të agroteknikës dhe të pajisura me maqina bujqësore.

Forcat e reja prodhuese kërkojnë që ata që punojnë në prodhim, të jenë më të kulturuar dhe të dinë më tepër se sa bujkrobërit e shtypur dhe të paditur, të jenë të aftë t'i njohin dhe t'i përdorin mirë maqinat. Prandaj kapitalistët preferojnë të kenë të bëjnë me punëtorë me mëditje, të çliruar nga prangat feudale dhe mjaft të kulturuar për t'i përdorur maqinat si duhet.

Por, pasi i zhvilloi forcat prodhuese në përpjesëtime kolosale, kapitalizmi u zhyt në kontradikta të pazgjidhshme për të. Duke prodhuar gjithnjë më tepër mallra dhe duke zbritur çmimet e mallrave, kapitalizmi e ashpërson konkurrencën, rrënon masën e pronarëve privatë, të vegjël e të mesëm, i kthen ata në proletarë

dhe pakëson fuqinë blerëse të tyre, kështu që shitja e mallrave të prodhuara bëhet e pamundur. Duke zgjeruar prodhimin dhe duke grumbulluar në fabrika dhe uzina shumë të mëdha miliona punëtorë, kapitalizmi i jep procesit të prodhimit një karakter shoqëror dhe shkallmon kështu vetë bazën e tij, sepse karakteri shoqëror i procesit të prodhimit kërkon pronën shoqërore mbi mjetet e prodhimit, ndërsa prona mbi mjetet e prodhimit mbetet pronë private kapitaliste, që nuk pajtohet me karakterin shoqëror të procesit të prodhimit.

Këto kontradikta të papajtueshme midis karakterit të forcave prodhuese dhe marrëdhënjeve të prodhimit shfaqen në krizat periodike të superprodhimit, kur kapitalistët, duke mos gjetur blerës të aftë për të paguar për shkak të rrënimit që u kanë sjellë ata vetë masave të popullsisë, janë të shtërnguar t'i djegin produktet, t'i prishin mallrat e gatshme, ta pezullojnë prodhimin, t'i shkatërrojnë forcat prodhuese në një kohë kur miliona njerëz janë të shtërnguar të vuajnë nga papunësia dhe nga uria jo sepse mungojnë mallrat, por sepse mallra janë prodhuar tepër.

Kjo do të thotë se marrëdhënjet kapitaliste të prodhimit nuk i përgjigjen më gjendjes së forcave prodhuese të shoqërisë dhe kanë rënë në një kontradiktë të papajtueshme me to.

Kjo do të thotë se kapitalizmi është i mbarsur me revolucionin, që duhet të zëvendësojë pronën e zotme kapitaliste mbi mjetet e prodhimit me pronën socialiste.

Kjo do të thotë se lufta shumë e ashpër e klasave midis shfrytëzuesve dhe të shfrytëzuarve përbën tiparin kryesor të rendit kapitalist.

Në rendin socialist, i cili tani për tani është realizuar vetëm në BRSS, baza e marrëdhënjeve të prodhi-

mit është prona shoqërore mbi mjetet e prodhimit. Këtu nuk ka më as shfrytëzues as të shfrytëzuar. Produktet që prodhohen, ndahen sipas punës në bazë të parimit «kush nuk punon, nuk ha». Këtu marrëdhënjet e njerëzve në procesin e prodhimit karakterizohen si marrëdhënje bashkëpunimi shoqëror dhe ndihme reciproke socialiste midis punonjësve të lirë nga shfrytëzimi. Këtu marrëdhënjet e prodhimit i përgjigjen plotësisht gjendjes së forcave prodhuese, sepse karakteri shoqëror i procesit të prodhimit përforcohet nga prona shoqërore mbi mjetet e prodhimit.

Prandaj prodhimi socialist në BRSS nuk i njeh krizat periodike të superprodhimit dhe të këqiat që sjellin ato me vete.

Prandaj forcat prodhuese këtu zhvillohen me një ritëm të shpejtë, sepse marrëdhënjet e prodhimit që u përgjigjen atyre, u lënë fushë të lirë për një zhvillim të tillë.

E tillë është pasqyra e zhvillimit të marrëdhënjeve të njerëzve në prodhim gjatë historisë së njerëzimit.

E tillë është varësia e zhvillimit të marrëdhënjeve të prodhimit nga zhvillimi i forcave prodhuese të shoqërisë, para së gjithash — nga zhvillimi i veglave të prodhimit, varësi e cila bën që ndryshimet dhe zhvillimi i forcave prodhuese shpejt a vonë të shpien në ndryshimin dhe në zhvillimin përkatës të marrëdhënjeve të prodhimit.

«Përdorimi dhe krijimi i mjeteve të punës *, thotë Marksi, ndonëse në formë embrionare, gjenden te disa lloje kafshësh, përbëjnë një tipar

* Me fjalët «mjetet e punës» Marksi kupton kryesisht veglat e prodhimit. *Red.*

karakteristik specifik të procesit njerëzor të punës, dhe për këtë arësye Franklini e përcakton njeriun si «*a tolmaking animal*», si një kafshë që bën vegla. Mbeturinat e mjeteve të punës kanë për studimin e formacioneve shoqërore-ekonomike të zhdukura të njëjtën rëndësi që ka struktura e kockave për studimin e organizmit të llojeve të kafshëve të zhdukura. Epokat ekonomike dallohen prej njëra-tjetrës jo nga sendet që prodhohen, por nga mënyra se si prodhohen... Mjetet e punës nuk shërbejnë vetëm për të matur shkallët e zhvillimit të fuqisë punëtore njerëzore, por janë edhe tregues të marrëdhënjeve shoqërore, në kuadrin e të cilave kryhet puna» (*K. Marks*, «Kapitali», bot. shqip, vëll. I, 1, f. 246-247).

Dhe më tej:

— «Marrëdhënjet shoqërore janë të lidhura ngushtë me forcat prodhuese. Duke gjetur forca të reja prodhuese, njerëzit ndryshojnë mënyrën e tyre të prodhimit, dhe me ndryshimin e mënyrës së prodhimit, e mënyrës së sigurimit të jetesës së tyre, — ata ndryshojnë të gjitha marrëdhënjet e tyre shoqërore. Mulliri me dorë na jep një shoqëri me suzerenin (feudalin. — *J.St.*) në krye, mulliri me avull — një shoqëri me kapitalistin industrial» (*K. Marks*, «Mjerimi filozofisë». *K. Marks* e *F. Engels*. Veprat, bot. i dytë rus., vëll. V, f. 364).

— «Parreshtur kryhet lëvizja e rritjes së forcave prodhuese, shkatërrimi i marrëdhënjeve shoqërore dhe lindja e ideve, i palëvizshëm është vetëm abstraksioni i lëvizjes» (po aty, f. 364)

Duke karakterizuar materializmin historik të formuluar në «Manifestin e Partisë Komuniste», Engelsi thotë:

> «Prodhimi ekonomik dhe struktura e shoqërisë, që rrjedh patjetër prej tij, formojnë në çdo epokë historike bazën e historisë politike dhe intelektuale të kësaj epoke... Në përshtatje me këtë që nga koha e shkatërrimit të pronës së përbashkët primitive të tokës e gjithë historia ka qenë histori e luftës së klasave, e luftës midis klasave të shfrytëzuara dhe shfrytëzuese, midis klasave të nënshtruara dhe sunduese në etapat e ndryshme të zhvillimit shoqëror... Tani kjo luftë ka arritur një shkallë, në të cilën klasa e shfrytëzuar dhe e shtypur (proletariati) nuk mund të çlirohet nga klasa që e shfrytëzon dhe e shtyp (borgjezia), pa çliruar njëkohësisht dhe përgjithmonë gjithë shoqërinë nga shfrytëzimi, shtypja dhe lufta e klasave...» (Parathënje e Engelsit për botimin gjermanisht të «Manifestit». *K. Marks* e *F. Engels*, «Manifesti i Partisë Komuniste», bot. shqip, 1968, f. VIII).

ç) *Veçoria e tretë* e prodhimit është se forcat e reja prodhuese dhe marrëdhënjet e prodhimit, që u përgjigjen atyre, nuk lindin në mënyrë të shkëputur nga rendi i vjetër, nuk lindin pas zhdukjes së rendit të vjetër, por në gjirin e rendit të vjetër, nuk lindin si rezultat i veprimtarisë së ndërgjegjshme, të paramenduar të njerëzve, por vetiu, në mënyrë të pandërgjegjshme, pavarësisht nga vullneti i njerëzve. Ato lindin vetiu dhe pavarësisht nga vullneti i njerëzve për dy arësye.

Së pari, sepse njerëzit nuk janë të lirë të zgjedhin këtë apo atë mënyrë prodhimi, sepse çdo brez i ri, kur hyn në jetë, i gjen gati forcat prodhuese dhe marrëdhënjet e prodhimit, si rezultat i punës së brezave të kaluar, dhe prandaj çdo brez i ri, që të ketë mundësi të

prodhojë të mira materiale, kohët e para duhet të pranojë çdo gjë që gjen të gatshme në fushën e prodhimit dhe t'u përshtatet atyre.

Së dyti, sepse, duke përmirësuar këtë apo atë vegël prodhimi, këtë apo atë element të forcave prodhuese, njerëzit nuk dinë, nuk kuptojnë dhe nuk mendojnë se ç'rezultate *shoqërore* do të sjellin këto përmirësime, por mendojnë vetëm për interesat e tyre të përditshme, për të lehtësuar punën e tyre dhe për të pasur një dobi imediate e të ndjeshme për veten e tyre.

Kur disa anëtarë të shoqërisë së komunës primitive filluan dalëngadalë dhe si nëpër terr të kalonin nga veglat prej guri në veglat prej hekuri, ata, natyrisht, nuk e dinin dhe nuk e mendonin se ç'rezultate *shoqërore* do të sillte ky zbulim i ri; ata nuk e kuptonin dhe nuk e dinin se kalimi në veglà prej metali ishte një revolucion në prodhim dhe se ky do të shpinte, në fund të fundit, në rendin e skllavërisë, — ata donin vetëm të lehtësonin punën e tyre dhe të nxirrnin një dobi imediate e të ndjeshme, — veprimtaria e tyre e ndërgjegjshme kufizohej me caqet e ngushta të kësaj dobie personale të përditshme.

Kur, në periudhën e rendit feudal, borgjezia e re e Evropës filloi të ndërtonte, pranë punishteve të vogla të zejtarëve, ndërmarrje të mëdha manufakturore dhe i shpuri kështu përpara forcat prodhuese të shoqërisë, ajo, sigurisht, nuk e dinte dhe nuk e mendonte se ç'pasoja *shoqërore* do të sillte kjo gjë e re, ajo nuk e dinte dhe nuk e kuptonte se kjo gjë e re «e vogël» do të sillte një rigrupim të tillë të forcave shoqërore, i cili do të mbaronte me një revolucion edhe kundër pushtetit të mbretit, favoret e të cilit ajo i çmonte aq tepër, edhe kundër fisnikëve, në radhët e të cilëve ëndërronin shpeshherë të hynin përfaqësuesit më të mirë të saj, —

ajo donte vetëm ta lironte prodhimin e mallrave, të hidhte sa më tepër mallra në tregjet e Azisë dhe të Amerikës së porsazbuluar dhe të nxirrte sa më shumë fitime, — veprimtaria e saj e ndërgjegjshme kufizohej me çaqet e ngushta të kësaj praktike të përditshme.

Kur kapitalistët rusë, së bashku me kapitalistët e huaj, filluan të ngrinin në Rusi, në mënyrë intensive, industrinë e madhe moderne, të mekanizuar, pa prekur carizmin dhe duke i lënë fshatarët në mëshirën e çifligarëve, ata, sigurisht, nuk e dinin dhe nuk e mendonin se ç'pasoja *shoqërore* do të sillte ky zhvillim i madh i forcave prodhuese, ata nuk e dinin dhe nuk e kuptonin se ky hop i madh në fushën e forcave prodhuese të shoqërisë do të shpinte në një rigrupim të tillë të forcave shoqërore, i cili do t'i jepte mundësi proletariatit të bashkonte me vete fshatarësinë dhe të kryente revolucionin socialist ngadhënjimtar, — ata donin vetëm të zgjeronin deri në kulm prodhimin industrial, të zotëronin tregun kolosal të brendshëm, të bëheshin monopolistë dhe të nxirrnin sa më tepër fitime nga ekonomia kombëtare, — veprimtaria e tyre e ndërgjegjshme nuk i kalonte kufijtë e interesave të tyre të ngushta praktike të përditshme.

Në lidhje me këtë Marksi thotë:

> «Në prodhimin shoqëror të jetës së tyre (domethënë në prodhimin e të mirave materiale, që nevojiten për jetesën e njerëzve. — *J. St.*) njerëzit hyjnë në marrëdhënje të caktuara, të domosdoshme, *të pavarura* * nga vullneti i tyre — në marrëdhënje prodhimi, të cilat i përgjigjen një shkalle të caktuar të zhvillimit të forcave

* Korsivi është i imi. *J. St.*

prodhuese materiale të tyre» (*K. Marks e F. Engels*, Vepra të zgjedhura në dy vëllime, bot. shqip, vëll. I, f. 335).

Por kjo nuk do të thotë se ndryshimet e marrëdhënjeve të prodhimit dhe kalimi nga marrëdhënjet e vjetra të prodhimit në të rejat bëhet në mënyrë të qetë, pa konflikte, pa tronditje. Përkundrazi, ky kalim bëhet zakonisht me anën e përmbysjes revolucionare të marrëdhënjeve të vjetra të prodhimit dhe me anën e vendosjes së marrëdhënjeve të reja. Deri në një farë periudhe zhvillimi i forcave prodhuese dhe ndryshimet në fushën e marrëdhënjeve të prodhimit bëhen vetiu, pavarësisht nga vullneti i njerëzve. Por kjo bëhet vetëm deri në një moment të caktuar, derisa forcat prodhuese, që kanë lindur e po zhvillohen, të kenë arritur pjekurinë e duhur. Kur piqen forcat e reja prodhuese, marrëdhënjet ekzistuese të prodhimit dhe bartësit e tyre, klasat sunduese, bëhen ajo pengesë «e pakapërcyeshme», e cila mund të hiqet nga rruga vetëm me anën e veprimtarisë së ndërgjegjshme të klasave të reja, me anën e veprimeve të dhunshme të këtyre klasave, me anën e revolucionit. Këtu duket veçanërisht qartë *roli shumë i madh* i ideve të reja shoqërore, i institucioneve të reja politike, i pushtetit të ri politik, që kanë për detyrë të zhdukin me forcë marrëdhënjet e vjetra të prodhimit. Mbi themelin e konfliktit midis forcave të reja prodhuese dhe marrëdhënjeve të vjetra të prodhimit, mbi themelin e nevojave të reja ekonomike të shoqërisë lindin idetë e reja shoqërore, idetë e reja organizojnë dhe mobilizojnë masat, masat bashkohen në një ushtri të re politike, krijojnë një pushtet të ri revolucionar dhe e përdorin atë për të zhdukur me forcë sistemin e vjetër në fushën e marrëdhënjeve të prodhimit dhe për të vendo-

sur një sistem të ri. Procesi spontan i zhvillimit i lëshon vendin veprimtarisë së ndërgjegjshme të njerëzve, zhvillimi paqësor — përmbysjes me forcë, evolucioni — revolucionit.

> «Proletariati, thotë Marksi, në luftën kundër borgjezisë formohet medoemos si klasë... me anën e revolucionit ai bëhet klasë sunduese dhe si klasë sunduese përmbys me forcë marrëdhënjet e vjetra të prodhimit» (*K. Marks* e *F. Engels*, «Manifesti i Partisë Komuniste», bot. shqip, 1968, f. 32).

Dhe pastaj:

> — «Proletariati e përdor sundimin e tij politik për të shkëputur nga duart e borgjezisë pak nga pak gjithë kapitalin, për të centralizuar të gjitha veglat e prodhimit në duart e shtetit, d.m.th. të proletariatit të organizuar si klasë sunduese dhe për t'i shtuar sa më shpejt forcat prodhuese» (po aty, f. 31.)
>
> — «Dhuna është mamia e çdo shoqërie të vjetër, kur kjo është e mbarsur me një shoqëri të re» (*K. Marks*, «Kapitali», bot. rus, vëll. I, f. 761).

Ja formulimi gjenial i thelbit të materializmit historik, që ka dhënë Marksi më 1859 në «Parathënjen» historike të librit të tij të famshëm «Rreth kritikës së ekonomisë politike»:

> «Në prodhimin shoqëror të jetës së tyre njerëzit hyjnë në marrëdhënje të caktuara, të domosdoshme, të pavarura nga vullneti i tyre — në marrëdhënje prodhimi, të cilat i përshtaten një shkalle të caktuar të zhvillimit të forcave prodhuese materiale të tyre. Të gjitha këto marrë-

dhënje prodhimi, të marra së bashku, përbëjnë strukturën ekonomike të shoqërisë, bazën reale, mbi të cilën ngrihet superstruktura juridike dhe politike dhe së cilës i përgjigjen forma të caktuara të ndërgjegjes shoqërore. Mënyra e prodhimit të jetës materiale kondicionon procesin shoqëror, politik dhe shpirtëror të jetës në përgjithësi. Nuk është ndërgjegjja e njerëzve që përcakton qenjen e tyre, por, përkundrazi, qenja e tyre shoqërore përcakton ndërgjegjen e tyre. Në një shkallë të caktuar të zhvillimit të tyre, forcat prodhuese materiale të shoqërisë vijnë në kundërshtim me marrëdhënjet ekzistuese të prodhimit ose — gjë që është vetëm shprehja juridike e kësaj — me marrëdhënjet e pronësisë, brenda të cilave ishin zhvilluar deri në këtë kohë. Nga forma të zhvillimit të forcave prodhuese këto marrëdhënje bëhen pranga për to. Atëherë fillon epoka e revolucionit social. Me ndryshimin e bazës ekonomike, shpejt a vonë përmbyset gjithë superstruktura kolosale. Kur analizojmë përmbysje të tilla, duhet të dallojmë gjithmonë përmbysjen materiale në kushtet ekonomike të prodhimit, të cilën mund ta konstatojmë me saktësinë e shkencave natyrore, nga përmbysjet juridike, politike, fetare, artistike ose filozofike; shkurt: nga format ideologjike, në të cilat njerëzit e kuptojnë këtë konflikt dhe luftojnë kundër tij. Ashtu si nuk mund të gjykohet për një njeri nga ajo që mendon ai vetë për veten e tij, pikërisht po ashtu nuk mund të gjykohet për një epokë të tillë përmbysjeje nga ndërgjegjja e saj. Përkundrazi, kjo ndërgjegje duhet shpjeguar me kontradiktat e jetës materiale, me konfliktin që ekziston midis forcave prodhuese shoqërore dhe marrëdhënjeve të prodhimit. Asnjë formacion shoqëror nuk vdes përpara se të zhvillohen plotësisht të gjitha forcat prodhuese, të cilave ai u lë mjaft fushë të lirë; dhe marrëdhënjet e reja të prodhimit, më të larta, nuk lindin kurrë për-

para se të pigen kushtet materiale të ekzistencës së tyre në vetë gjirin e shoqërisë së vjetër. Prandaj njerëzimi i shtron vetes gjithmonë vetëm detyra të tilla, të cilat mund t'i zgjidhë, sepse, po ta shohim punën së afërmi, kurdoherë na del se edhe detyra lind vetëm atëherë, kur ekzistojnë kushte materiale për zgjidhjen e saj'ose, të paktën, kur këto kushte janë në formim e sipër» (*K. Marks* e *F. Engels*, Vepra të zgjedhura në dy vëllime, bot. shqip. vëll. I, f. 335-336)

Kështu qëndron puna me materializmin marksist, po ta zbatojmë atë në jetën shoqërore, po ta zbatojmë atë në historinë e shoqërisë.

Këto janë tiparet themelore të materializmit dialektik dhe historik.

Shtator, 1938.

Tirazhi: 60.000 kopje Formati: 84 x 110/32 Stash: 2204-65

Shtypur në NISH Shtypshkronjave «MIHAL DURI»
Stabilimenti i Botimeve Arësimore — Tiranë 1968

Çmimi: Lekë 0.50